# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7066
E shtunë, 9 dhjetor 2023
Çmimi 0. 50


Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

## Osmani takon Erdoganin, e falënderon për mbështetjen e fuqishme dhënë Kosovës

FAQE 7




AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# OPOZITA SHPREH SHQETËSIME DHE MOSPAJTIME PËR DRAFT-STATUTIN E ASOCIACIONIT



Përfaqësues të dy partive opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, shprehin shqetësimin e tyre se draft-statuti për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë prek karakterin unitar të shtetit dhe krijon paralelizma në pushtete. Ndërsa nga Partia Demokratike e Kosovës, subjekti më i madh opozitar në vend, nuk dhanë ndonjë koment në lidhje me të

## PROKURORIA E KOSOVËS NGRE AKTAKUZË KUNDËR 53 PERSONAVE PËR MASAKRËN E MEJËS DHE TË FSHATRAVE TË REKËS SË KEQE F. 5





## ZEMAJ: VITIA KA LARGUAR NGA STRATEGJIA LIGJIN PËR SHËNDETËSI DHE LIGJIN PËR SIGURIME SHËNDETËSORE F. 3

## OPINION

### HIPOKRIZIA NË FORMË TË FTESËS PËR OPOZITËN E DHUNUAR NGA POZITA DHE JANUSE PRESIDENTJA! F. 9

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



## AKTUALE

### ÇFARË PRITET NGA SAMITI BE - BALLKANI PERËNDIMOR? F.3

### "KEQPËRDORIMI I MARRËVESHJEVE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA NË NIVELIN QENDROR" F. 7

## EKONOMI



### BANKAT NË KOSOVË FITUAN MBI 140 MILIONË EURO DERI NË TETOR F. 8

### KEDS-I DHE KESCO PO IMPORTOJNË ENERGJI ELEKTRIKE MBI 1 MILION EURO NË DITË F. 8

## KULTURË




### DOLI NGA SHTYPI BOTIMI I DYTË I LIBRIT TË MR. SCI. HAMZ S. LLADROVCIT F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

## "Gjendje krize" shpallet fjala e vitit në Gjermani



BERLIN, 8 DHJETOR - Një juri e ekspertëve gjermanë e ka shpallur fjalën "Krisenmodus" (gjendje krize) si fjalën e vitit 2023, si referencë për luftën në Ukrainë dhe Lindje të Mesme, për sfidat globale dhe rënien e standardeve të edukimit në këtë shtet.
"Antisemitizmi" është renditur në vendin e dytë, ka thënë Shoqata për Gjuhën Gjermane të premten, duke e përmendur rritjen e përdorimit të kësaj fjale prej sulmeve të grupit palestinez Hamas, në tokën izraelite, më 7 tetor.
Hamasi, grup që udhëheq Gazën, është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.
Në vendin e tretë është renditur shprehja "pamundësi për të lexuar" duke iu referuar jo vetëm analfabetizmit, por edhe rritjes së vështirësive nga njerëzit që të kuptojnë tekste komplekse.
Sipas shoqatës që e ka përpiluar listën "renditja reflekton realitetin - dhe realiteti është goxha i zymtë". Sipas saj, shoqëria ka qenë në "gjendje krize" prej vitit 2020, duke e përmendur pandeminë e koronavirusit, luftën e Rusisë në Ukrainë, krizat gjermane në edukim dhe energji, dhe sulmet e Hamasit në Izrael në tetor.
Militantët e Hamasit e kanë nxitur luftën me Izraelin pas sulmit që kanë kryer në territorin e tij më 7 tetor, duke vrarë mbi 1 200 njerëz dhe duke marrë peng 240 të tjerë. Për pasojë, Izraeli ka nisur ofensivë tokësore dhe ajrore në Gazën me 2.3 milionë banorë. Sipas autoriteteve shëndetësore palestineze, mbi 15 800 njerëz kanë vdekur si pasojë e sulmeve izraelite.
Ushtria izraelite, në anën tjetër, i vë fajin Hamasit për vrasjet, duke e akuzuar se po operon në zonat e dendura me civilë.

# Ambasada Amerikane në Bagdad sulmohet me raketa



BAGDAD, 8 DHJETOR - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Bagdad është sulmuar me dy breshëri raketash, në mëngjesin e së premtes, të cilat nuk kanë shkaktuar viktima, ka njoftuar një zëdhënës i ambasadës.
Sulmi besohet të jetë kryer nga militantët e lidhur me Iranin në Irak, ka thënë zëdhënësi. Asnjë grup nuk e ka marrë menjëherë përgjegjësinë, raporton "Reuters".
Ky ishte sulmi i parë i raportuar me raketa kundër ambasadës, që kur një rrjet grupesh militante të myslimanëve shiitë, të lidhura me Iranin, nisën sulme kundër forcave amerikane në baza ushtarake në Irak dhe në Sirinë fqinje, në mesin e tetorit.
Grupet e armatosura, të cilat operojnë nën flamurin e Rezistencës Islamike në Irak, i kanë lidhur më shumë se 70 sulme të tilla me mbështetjen e Uashingtonit për Izraelin, në luftën e tij shkatërruese në Gazë.
"Ne i bëjmë përsëri thirrje Qeverisë së Irakut, siç kemi bërë në disa raste, që të bëjë gjithçka që mundet për ta mbrojtur personelin dhe objektet e partnerëve diplomatikë dhe të koalicionit", ka thënë zëdhënësi i ambasadës.
Shpërthimet u dëgjuan afër ambasadës, në qendër të kryeqytetit të Irakut, rreth orës 4 të mëngjesit të së premtes. U aktivizuan edhe sirenat që u bënin thirrje njerëzve të zinin vende të sigurta, sipas videove nga vendi i ngjarjes të publikuara në mediet sociale.
Përveç stafit diplomatik në Irak, Shtetet e Bashkuara kanë edhe rreth 2 500 trupa në vend, në një mision që ato thonë se ka për synim të këshillojnë dhe t'u ndihmojnë forcave vendëse, që po përpiqen të parandalojnë një ringjallje të grupit Shteti Islamik, i cili më 2014 mori nën kontroll pjesë të mëdha të Irakut dhe të Sirisë para se të mposhtej. "Ne përsërisim se kemi të drejtë të vetëmbrohemi dhe ta mbrojmë personelin tonë kudo në botë", është shprehur zëdhënësi.

# Putini thotë se do të kandidojë në zgjedhjet presidenciale të Rusisë në mars



MOSKË, 8 DHJETOR - Presidenti rus Vladimir Putin ka njoftuar se do të kandidojë edhe për një mandat në zgjedhjet presidenciale të Rusisë të planifikuara për 17 mars 2024. Sipas agjencisë shtetërore ruse të lajmeve, TASS, Putini ka njoftuar se do të kandidojë sërish, pasi mori pjesë në një ceremoni në Kremlin, për të nderuar me 'Yllin e artë të heroit' ushtarët që kishin marrë pjesë në luftën në Ukrainë.
Aty Putini u pyet nga një kolonel nëse do të kandidonte përsëri dhe ai e pohoi këtë. Një mandat i ri do ta mbante atë në pushtet të paktën deri në vitin 2030.
Putinit iu dorëzua mandati i presidentit nga Boris Yeltsin në vitin 1999 dhe prej atëherë ka qëndruar në pushtet si president apo kryeministër.
Politikanët e opozitës i cilësuan zgjedhjet si një gjethe fiku të demokracisë që e zbukuron atë që ata e shohin si diktaturë të korruptuar të Rusisë së Putinit.
Politikani i burgosur i opozitës, Aleksei Navalny, dhe mbështetësit e tij u kërkuan personave me të drejtë vote në Rusi që të votojnë për "çdo kandidat tjetër" përveç Putinit, edhe pse "rezultatet përfundimtare do të manipulohen".
Putini, megjithatë, nuk ka bërë ende një njoftim zyrtar nëse ai do të kandidojë në zgjedhjet e planifikuara që mbahen mes 15 dhe 17 marsit të vitit të ardhshëm.
Sipas analistëve, Putini nuk do të përballet me asnjë kundërshtar të madh dhe pritet të kërkojë një mandat sa më të madh që të jetë e mundur për t'i fshehur mosmarrëveshjet e brendshme rreth luftës në Ukrainë.

## Djali i presidentit Biden akuzohet për shmangie nga tatimi



UASHINGTON, 8 DHJETOR - Prokurorët federalë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë ngritur aktakuzë kundër djalit të presidentit Joe Biden për shmangie nga tatimi.
Hunter Biden "shpenzoi miliona dollarë për një mënyrë jetese ekstravagante në vend që ta paguante tatimin", tha në një deklaratë prokurori special David Weiss.
Sipas aktakuzës, Bideni planifikoi shmangien nga tatimi prej, së paku, 1.4 milion dollarë gjatë viteve 2016-2019.
Nëse shpallet fajtor, Hunter Biden, 53 vjeç, mund të dënohet deri 17 vjet burgim.
Lidhur me këtë rast, avokati mbrojtës Abbe Lowell e akuzoi prokurorin Weiss për "përkulje ndaj presionit republikan". "Bazuar në faktet dhe ligjin, nëse mbiemri i Hunterit nuk do të ishte Biden, akuzat në Delaware dhe tani në Kaliforni nuk do të ishin ngritur", tha Lowell në një deklaratë.
Shtëpia e Bardhë nuk pranoi të komentojë mbi këtë çështje.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Çfarë pritet nga samiti BE - Ballkani Perëndimor?



PRISHTINË, 8 DHJETOR - Më 13 dhjetor në Bruksel pritet të zhvillohet samiti i përbashkët i liderëve të Bashkimit Evropian me kolegët e tyre nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Kosovën në këtë samit pritet ta përfaqësojë presidentja Vjosa Osmani, ndërsa Serbinë kryeministrja Ana Bërnabiq.

Normalizimi i raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë pritet të jetë një prej temave kryesore të debatit pasi vlerësohet se këto raporte janë kyçe për stabilitetin e gjithë rajonit. Kosova dhe Serbia janë pjesë e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja për normalizim të raporteve prej vitit 2011. Palët kanë nënshkruar një mori marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar.

Në këtë samit pritet të miratohet edhe një deklaratë e përbashkët, me të cilën do të konfirmohet, nga njëra anë, orientimi strategjik i rajonit për integrim në BE dhe, në anën tjetër, edhe përkushtimi i BE-së në këtë drejtim.

"Radio Evropa e Lirë" ka pasur qasje në draftin e deklaratës që pritet të miratohet në këtë samit. Bashkimi Evropian edhe përmes kësaj deklarate do ta përsërisë përkushtimin e parezervë për perspektivën e anëtarësimit në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe përshpejtimin e këtij procesi bazuar në meritat individuale të vendeve kandidate në procesin e reformave dhe përmbushjen e kritereve. Këtu, para së gjithash, nënvizohet nevoja për përparim në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit dhe për respektimin e parimeve dhe vlerave themelore të Bashkimit Evropian.

Teksti i draftit është përpiluar nga Bashkimi Evropian dhe pritet që atë ta mbështetin edhe liderët e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Edhe nga ky samit pritet t'u bëhet thirrje Kosovës dhe Serbisë që pa vonesa t'i përmbushin obligimet nga dialogu të cilin e lehtëson Bashkimi Evropian. "Ne vazhdojmë t'i mbështetim përpjekjet e përfaqësuesit të lartë të BE-së dhe përfaqësuesit të posaçëm për dialog në mes të Beogradit dhe Prishtinës dhe çështje të tjera rajonale në Ballkanin Perëndimor. Presim angazhim konstruktiv nga palët për të arritur përparim të shpejtë për normalizimin e raporteve të tyre, që është kyç për sigurinë dhe stabilitetin në gjithë rajonin dhe për ta siguruar avancimin e të dyja palëve në rrugëtimin e tyre përkatës evropian", thuhet në draftin e kësaj deklarate të përbashkët. "U bëjmë ftesë të dyja palëve që në tërësi ta zbatojnë Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve dhe aneksin e saj, si dhe të gjitha marrëveshjet nga e kaluara, pa asnjë vonesë të re dhe pa parakushte", thuhet më tej në pjesën që u kushtohet raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Aty, po ashtu, përsëritet edhe ftesa për t'i ulur tensionet në veri të Kosovës. "Ne, po ashtu, presim nga palët të bëjnë përpjekje të qëndrueshme për uljen e tensioneve në përputhje me kërkesat e BE-së dhe të përmbahen nga veprimet e njëanshme dhe të pakoordinuara që mund të çojnë deri te tensionet e reja dhe dhuna, si dhe të përmbahen nga retorika e cila nuk është në përputhje me normalizimin e raporteve", thuhet në tekst.

Bashkimi Evropian do t'u bëjë ftesë të gjithë partnerëve nga rajoni i Ballkanit Perëndimor që t'i zgjidhin të gjitha mospajtimet e tyre dhe çështjet e hapura.

BE-ja në këtë samit do ta shprehë edhe përkushtimin për t'i ndihmuar vendet e rajonit në përballje me pasojat e agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës, si në aspektin e energjisë, po ashtu edhe në përballje me kërcënimet hibride që vijnë nga Rusia.

Sa iu përket qëndrimeve ndaj Rusisë, BE-ja pritet të shprehë mirënjohje për vendet të cilat janë përshtatur me qëndrimet e Bashkimit Evropian dhe të kërkojë nga ato që nuk e kanë bërë një gjë të tillë, që ta bëjnë sa më parë. Kjo ka të bëjë, para së gjithash, me Serbinë, që vazhdon të jetë i vetmi vend në rajon që nuk i ka mbështetur sanksionet ndaj Rusisë.

"Përderisa ne thellojmë bashkëpunimin tonë me partnerët, ne u bëjmë ftesë atyre të bëjnë përparim të shpejtë dhe të qëndrueshëm drejt përshtatjes së plotë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së, përfshirë edhe masat restriktive të BE-së në këtë drejtim. Ne vlerësojmë ata partnerë nga Ballkani Perëndimor, të cilët tashmë kanë dëshmuar përkushtimin e tyre strategjik duke u përshtatur në tërësi me politikën e jashtme të BE-së dhe i inkurajojmë ato të cilat nuk e kanë bërë një gjë të tillë deri më tash, që ta ndjekin këtë rrugë. Ne, po ashtu, i inkurajojmë përpjekjet e përmirësuara për t'i zbatuar masat restriktive dhe parandalimin e anashkalimit të tyre", thuhet në këtë tekst.

Samiti i BE-së dhe Ballkanit Perëndimor do të zhvillohet më 13 dhjetor, një ditë para se të mblidhet edhe Këshilli Evropian, ku zgjerimi do të jetë një prej temave kryesore.

# Zemaj: Vitia ka larguar nga strategjia Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për Sigurime Shëndetësore

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**



PRISHTINË, 8 DHJETOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, ka folur të premten për gjendjen e shëndetësisë në vend. Zemaj ka thënë se gjatë tri vjetëve të qeverisjes së Vetëvendosjes ka vetëm përkeqësim të gjendjes në shëndetësi. "Po kalojnë tri vjet nga kjo qeverisje, gjendja në shëndetësi vetëm po përkeqësohet edhe më shumë. Këtë nuk po e themi ne si LDK, por nga gazetarët që raportojnë e deri te raporti i fundit i raportit të progresit. Menaxhmenti i drejtorëve në spitalin e Mitrovicës ka dhënë dorëheqje. Këto po ndodhin ashtu siç kemi thënë se ka ndërhyrje të Ministrisë së Shëndetësisë në punën e stafit shëndetësor. Po ashtu, në emergjenca mungojnë gjërat elementare", ka thënë Zemaj.

Deputeti Zemaj ka thënë se qeveria nuk ka punuar fare në shëndetësi. "Ja faktet të cilat tregojnë se nuk ka punuar fare. Për tri vjet janë ndërruar tre ministra. Nuk ka asnjë strategji në shëndetësi. Më shumë se 200 mjekë po ikin çdo vit. Për ikjen e tyre nuk ka asnjë reagim nga qeveria. Nuk kemi asnjë investim kapital. Kemi ankesa të njëjta nga të gjitha odat e profesionistëve shëndetësorë", u shpreh ai.

Më tutje, Zemaj ka thënë se Ligjin për Shëndetësi dhe atë për Sigurimet Shëndetësore i ka larguar vetë ministri Vitia nga strategjia. "Fondi Shëndetësor të cilin e ka premtuar ministri Vitia që tri vjet nuk e kemi askund, madje lajmi kryesor i ditës, të cilin po e them për herë të parë në këtë konferencë, është se pikërisht ky ministër e ka larguar nga strategjia Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për Sigurimet Shëndetësore. Kam informacione të sakta, të konfirmuara, se ky ligj është bartur për vitin e ardhshëm ashtu siç është bartur që tri vjet me radhë. Domethënë, prioritetet dhe premtimet që erdhën nga qeveria në pushtet tani po kalojnë në bartje në vitet e ardhshme", ka thënë Zemaj, duke shtuar se gjendja në sistemin e shëndetësisë ka degraduar. "Ka keqmenaxhim dhe ka korrupsion", ka theksuar Zemaj, ndërsa ka thënë se njerëzit janë duke vuajtur për barna.



# Opozita shpreh shqetësime dhe mospajtime për draft-statutin e Asociacionit

Përfaqësues të dy partive opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, shprehin shqetësimin e tyre se draft-statuti për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë prek karakterin unitar të shtetit dhe krijon paralelizma në pushtete. Ndërsa nga Partia Demokratike e Kosovës, subjekti më i madh opozitar në vend, nuk dhanë ndonjë koment në lidhje me të

**PRISHTINË, 8 DHJETOR** - Përfaqësues të dy partive opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, shprehin shqetësimin e tyre se draft-statuti për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë prek karakterin unitar të shtetit dhe krijon paralelizma në pushtete.

Nga Partia Demokratike e Kosovës, subjekti më i madh opozitar në vend, nuk dhanë ndonjë koment në lidhje me të. Deputetja e kësaj partie, Ariana Musliu - Shoshi, u shpreh e rezervuar, duke thënë shkurtimisht për "Radion Evropa e Lirë" se deputetët e PDK-së nuk e kanë marrë draft-statutin e Asociacionit për ta lexuar dhe shqyrtuar, pasi drejtuesit e partisë nuk ua kanë dorëzuar.

"REL"-i bëri përpjekje ta kontaktojë kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqi, dhe nënkryetaren Vlora Çitaku, por ata nuk iu përgjigjën thirrjeve dhe mesazheve telefonike.

Draft-statuti i hartuar nga diplomacia perëndimore iu dorëzua Qeverisë së Kosovës, ashtu si edhe asaj të Serbisë, në fund të tetorit.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, thanë se dokumenti është i pranueshëm për ta. Ky dokument duhet t'i ofrojë një nivel të caktuar të vetëmenaxhimit komunitetit serb në Kosovë. Ai iu dorëzua së voni edhe partive opozitare në vend.

### LDK-ja: Serbisë i jepet e drejta për rregullimin e brendshëm të Kosovës

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se kjo parti është ende duke e analizuar dokumentin, por nga ajo që ka parë deri më tash, draft-statuti ka "përmbajtje shqetësuese" në disa pika. Sipas tij, dokumenti përfshin preambulën që i referohet Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe në këtë pikë, thotë ai, Kosova dhe Serbia, si palë, barazohen në çështjet që i takojnë Kosovës t'i rregullojë. "Ky është një nga problemet e para. Problemi i dytë është Komisioni i Arbitrazhit, sepse palët do të kenë mundësi për një përbërje të përbashkët të përzier. Së treti, i jepet Serbisë, si palë në marrëveshje, e drejta jo vetëm në rregullimin e brendshëm të Kosovës... ajo do të ketë edhe mekanizma për zbatim të përhershëm.... Natyrisht se ka edhe çështje të tjera që ne me kohë do t'i definojmë", thotë Haziri.

### AAK-ja: Dokument shqetësues

Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, shprehu shqetësimet e tij lidhur me draft-statutin e Asociacionit. Në një intervistë për transmetuesin publik të Kosovës, RTK, ai tha se i gjithë dokumenti është shqetësues, në veçanti Komisioni i Arbitrazhit si mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Sipas tij, në këtë pikë "bie fuqia e cilitdo institucion ligjor në Kosovë". "Si mund tash t'i ikim Gjykatës Kushtetuese ose gjykatave të tjera në kontestet mes palëve dhe të krijohen trupa 'ad hoc', që nuk figurojnë as në Kushtetutë, as në ligjet tona dhe askund? Është edhe preambula. Është e panevojshme dhe tërësisht duhet të hiqet", tha Haradinaj. Ai shtoi se përmbajtja e draft-statutit të Asociacionit shpërfaq një lloj mosbesimi ndaj institucioneve qendrore të Kosovës në raport me serbët vendorë dhe anasjelltas.

### Reagimet opozitare "pa energji të caktuar"

Njohësi i zhvillimeve politike në Kosovë, Arton Demhasaj, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se pajtohet me shqetësimet e shprehura nga partitë opozitare. Por, sipas tij, këto parti duhet konkretisht dhe hapur ta shprehin mospajtimin si dhe të japin mendime se si duhet të duken pikat për të cilat nuk pajtohen. "Kemi parë vetëm disa reagime opozitare të cilat nuk janë krejt në rregull për aq kohë sa nuk kanë referenca të caktuara dhe nuk kanë energji të caktuar. Opozita, edhe kur kundërshton disa pika të një dokumenti, siç është rasti tash me draft-statutin, duhet të dalë me zgjidhje dhe të thotë: kjo nuk bën të jetë kështu, por duhet të jetë kështu", thotë Demhasaj.

Kompetencat e Asociacionit janë pikërisht arsyet përse Kosova ka hezituar ta themelojë atë, edhe pse marrëveshja me Serbinë për të është arritur qysh në vitin 2013. Qeveritë e Kosovës kanë shprehur vazhdimisht shqetësime se kompetencat e tij të gjera mund të ndikojnë në funksionalitetin e shtetit.

Në fillim të këtij muaji, "Radio Evropa e Lirë" siguroi qasje në draft-statutin e hartuar nga zyrtarët evropianë, sipas të cilit, parashihet qartazi mundësia e mbështetjes financiare të Asociacionit nga ana e Serbisë, si dhe "një kanal efikas dhe i drejtpërdrejtë i komunikimit ndërmjet komunitetit serb të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal".

Pjesa e draft-statutit të Asociacionit që u referohet kompetencave të tij, specifikon se ky organ ka të drejtë të miratojë vendime, rregullore, udhëzime dhe deklarata. Gjithashtu, ka kompetenca të plota mbi nivelin lokal, përkatësisht në fushat e zhvillimit ekonomik, planifikimit hapësinor, shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes së identitetit kulturor dhe fetar.

Në pjesën për marrëdhëniet me pushtetin qendror thuhet se Asociacioni nuk do t'i cenojë apo anashkalojë autoritetet kushtetuese dhe ligjore dhe kompetencat e tyre, si dhe nuk do t'i cenojë në asnjë mënyrë marrëdhëniet kushtetuese dhe juridike ndërmjet pushtetit

# Instituti për Hulumtimin dhe Dokumentimin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë mban takimin e parë



Prishtinë, 8 dhjetor - Është mbajtur takimi i parë zyrtar i hapur i Institutit për Hulumtimin dhe Dokumentimin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë. "Pas një rruge të gjatë për të krijuar një themel të fortë, jam fort i lumtur t'ju uroj mirëseardhje në takimin e parë zyrtar të hapur të Institutit për Hulumtimin dhe Dokumentimin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë", u shpreh kryeministri Kurti gjatë fjalës së tij. "Duhet të sigurohemi që të bëjmë më të mirën që mundemi që t'i adresojmë të gjithë ato që kanë ndodhur gjatë luftës së fundit në Kosovë. Kemi më shumë se 13 000 persona të vrarë gjatë luftës së fundit, mijëra persona të përdhunuar, mijëra të torturuar e të burgosur." shtoi ai.
Ai theksoi se Instituti për herë të parë në historinë e pasluftës parasheh divizion të veçantë për dëmin e shkaktuar material e jomaterial dhe për nevojat e viktimave.

Në përmbyllje të fjalës së tij, kryeministri fuqizoi mesazhin se qëllimi i të gjithë neve është i përbashkët: krijimi i kujtesës kolektive, e cila nuk do të na shërbejë vetëm neve, por edhe gjeneratave të ardhshme që do të vijnë pas nesh. "Historia është e mbushur me mësime të dhimbshme por, mbase, pjesa më e rëndësishme për t'u mbajtur në mend është që paqja kërkon drejtësi dhe rehabilitim. Në Kosovë nuk ka ndodhur asnjëra, e viktimat e luftës i meritojnë të dyja", tha kryeministri.
Me këtë rast Drejtori i Institutit për Hulumtimin dhe Dokumentimin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës, Atdhe Hetemi, u shpreh se Instituti simbolizon një hap të rëndësishëm për mbështetjen dhe përpjekjen e tij për njohje dhe promovim të së vërtetës, për krijimin e parakushteve për paqe të qëndrueshme në Kosovë dhe rajon.
Synimi kryesor është bashkëpunimi i ngushtë me të gjithë ata që kanë interes në dokumentimin, hulumtimin dhe zgjerimin e njohurive rreth krimeve të kryera gjatë luftës, ku veçoi se Instituti do të punojë në shërbim të paqes dhe drejtësisë e do të sigurohet që krimet të cilat kanë ndodhur në Kosovë, të mos kalohen pa u dokumentuar si detyrë e institutit ndaj viktimave dhe shoqërisë.

# Prokuroria e Kosovës ngre aktakuzë kundër 53 personave për masakrën e Mejës dhe të fshatrave të Rekës së Keqe



EPOKA E RE Faton Dërmaku

Prishtinë, 8 dhjetor - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur të premten aktakuzë për masakrën e Mejës dhe të fshatrave të regjionit Reka e Keqe të komunës së Gjakovës.
Prokuroria Speciale ka njoftuar se në periudhën 27-29 prill 1999 ishte zhvilluar një operacion i përbashkët dhe mirë i organizuar i UJ-së dhe MPB-së në të cilin morën pjesë edhe anëtarë të grupeve paramilitare.
Në atë operacion janë vrarë treqind e shtatëdhjetë (370) civilë që nuk merrnin pjesë në luftime në çastin e vrasjes. Përveç vrasjeve, operacioni përfshinte dëbimin e mijëra civilëve nga ai regjion, djegien e shtëpive të tyre dhe dërgimin e dhunshëm për në Shqipëri. Këto dëbime ishin të përfshira me keqtrajtime dhe konfiskime të dokumenteve personale të dëbuarve.
Për këtë krim janë akuzuar pesëdhjetë e tre (53) të pandehur prej të cilëve gjashtëmbëdhjetë (16) ishin të pozicionuar në strukturat e rëndësishme ushtarake dhe policore të Serbisë.
Të pandehurit me aktakuzë akuzohen për vepër penale në bashkëkryerje, krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht e inkriminiuar si krimet kundër njerëzimit nga neni 143 paragrafi 1 pika 1.1, 1.2, 14, 1.6, 1.8, 1.9 nënparagrafi 1.4, 1.6, dhe 1.7 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

qendror dhe atij lokal gjatë përmbushjes së qëllimeve të tij.
Shtohet se Asociacioni ka të drejtë të iniciojë apo të jetë palë në procedurat para gjykatave, përfshirë Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, nëse vendimet apo veprimet e ndonjë institucioni ndikojnë në ushtrimin e kompetencave të tij në përputhje me statutin.
Në rast se dy palët kanë mospajtime rreth statutit ose interpretimit të tij, që nuk mund të zgjidhen përmes negociatave direkte, ato duhet t'i referohen Komisionit të Arbitrazhit, që i themelon vetë rregullat e procedurës.
Qeveria e Kosovës nuk deshi ta komentojë draft-statutin në fjalë, por burime të "REL"-it në Bruksel konfirmuan se është një nga draftet e fundit.

### Kushtetuesja nuk mund ta "rinegociojë dokumentin"

Sipas përfaqësuesve opozitarë, kurdo që Qeveria e Kosovës të marrë vendim për draftin final të statutit të Asociacionit, rrjedha logjike është që ai dokument të shkojë për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese.
Haziri thotë se Gjykata Kushtetuese - çfarëdo që ta ketë vlerësimin e saj - nuk mund ta ndryshojë statutin e Asociacionit, por vetëm mund të japë mendim se është ose jo në frymën kushtetuese. "Ajo [Gjykata Kushtetuese] do ta ketë fjalën e vet gjithsesi. Por, ajo nuk mund ta rinegociojë [statutin e Asociacionit] ose nuk mund të dalë me një qëndrim tjetër ndaj një marrëveshjeje ndërkombëtare të pranuar nga palët. Kjo është rrjedha logjike që pritet të ndodhë...", thekson Haziri.
Por, lideri i AAK-së, Haradinaj, tha se vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese duhet të bëhet për çdo nen të draft-statutit të Asociacionit si dhe të konstatohet se ku ka mospërputhje me Kushtetutën e Kosovës. "E kemi marrë një zotim publik nga amerikanët dhe nga ndërmjetësit [e BE-së] se nuk do të ndryshojë Kushtetuta e Kosovës, sovraniteti, integriteti territorial... në rregull. Atëherë, gjykatësit tanë janë interpretues. Ata le të tregojnë se ku tejkalohet ose ku ka s'përputhje me Kushtetutën tonë. Por, duhet ta shqyrtojnë", tha Haradinaj.
Demhasaj shpreh mendimin se vlerësimi i dokumentit final për statutin e Asociacionit nga ana e Gjykatës Kushtetuese është i pritshëm, por ai nuk do ta ndryshojë dokumentin si fakt. "Mendoj se vetë fakti që ai dokument nuk po publikohet [zyrtarisht] dhe fakti që ai dokument nuk po diskutohet në publik, si dokument zyrtar, lë të kuptohet se të gjitha çështjet që mund të jenë diskutabile, do të rregullohen. Më pas, kur të rregullohen të gjitha ato çështje, do të publikohet. Pastaj në Gjykatë Kushtetuese do të dërgohet vetëm sa për sy e faqe, që të thuhet se shkoi në Gjykatë Kushtetuese", thotë Demhasaj.
Përfaqësuesit e LDK-së dhe të AAK-së gjithashtu thonë se draft-statuti i Asociacionit është produkt i marrëveshjes, sipas tyre "të keqe", të Kosovës me Serbinë, për normalizimin e marrëdhënieve, e njohur si Marrëveshja e Ohrit.
Nisur nga kjo marrëveshje, bashkësia ndërkombëtare ka rritur trysninë mbi Kosovën që ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, ndërsa mbi Serbinë që ta njohë de facto Kosovën.

# Fillojnë renovimet në Klinikën e Urologjisë

**Prishtinë, 8 dhjetor** - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, së bashku me drejtorin e ShSKUK-së, Elvir Azizi, kanë vizituar Klinikën e Urologjisë. Ata janë pritur nga drejtori i Klinikës, dr. Petrit Nuraj.

Edhe në këtë klinikë do të ketë renovime rrënjësore për shërbime cilësore, krijim të hapësirave të përshtatshme për shërbime mjekësore, ambiente komode, përmirësim të infrastrukturës e të gjitha këto ndërhyrje do të jenë në funksion të shërbimit të qytetarëve dhe stafit shëndetësor.

Përmes investimit me vlerë mbi 1.2 milion euro, në hapësirat e kësaj klinike pritet të bëhet renovimi i hapësirave pritëse dhe riorganizimi i sportelit; Sallat operative - zhvendosja e ESWL (aparatit për thyerje të gurëve) dhe cistoskopisë në lokacionin e bodrumit të Kirurgjisë; dhe renovimi i dhomave.





# Përparim Rama paraqet 100 biçikletat e reja të cilat do të përdoren për transport publik

Prishtinë, 8 dhjetor - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka paraqitur 100 biçikletat e reja të cilat do të përdoren për transport publik, të cilat tashmë kanë ardhur. “Shpejt fillojmë me krijimin e 10 stacioneve ku do të vendosen ato. Në të njëjtën kohë jemi duke krijuar shtigje të reja për biçikleta, të cilat do të lehtësojnë udhëtimin me to, duke e bërë më të sigurt. Përdorimi i biçikletës ndihmon në reduktimin e ndotjes së ajrit e po ashtu në përmirësimin e shëndetit tonë fizik e mendor”, ka shkruar Rama në “Facebook”.

# Totaj pret në takim ambasadorin e Luksemburgut, diskutojnë për kulturën, arsimin dhe ekonominë

**Prizren, 8 dhjetor** - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur në takim ambasadorin e Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz, me të cilin ka diskutuar për fuqizimin e marrëdhënieve në të gjitha sferat, që do të ndikonin në zhvillimin e jetës kulturore, sportive, arsimore dhe biznesore në këtë komunë. “Me theks të veçantë biseduam për zhvillimin ekonomik duke u fokusuar në trajnimin e të rinjve për tregun aktual të punës dhe ecjen në hap me teknologjinë informative. Gjithashtu, shtjelluam mundësinë e shkëmbimit të artistëve në festivale të të dyja shteteve që do ta ngrinin nivelin artistik në nivele të larta”, ka shkruar Totaj në “Facebook”.






# Komuna e Zveçanit pajiset me veturë për transport të vaksinave dhe vizitave në shtëpi

**Zveçan, 8 dhjetor** - Në zbatim të programit për vizitat në shtëpi dhe planit të veprimi për vizitat në shtëpi, Ministria e Shëndetësisë dhe komuna e Zveçanit nënshkruan marrëveshjen për veturën e siguruar për zinxhirin e ftohtë dhe për realizimin e vizitave në shtëpi.

Ministria e Shëndetësisë për komunat në nivel vendi, përmes huamarrjes së Bankës Botërore, ka siguruar 23 vetura në vlerë prej 782 000.00 euro me qëllim të lehtësimit të punës për realizimin e vizitave në shtëpi për shëndetin e nënës dhe fëmijës, kujdesin paliativ, si dhe në mënyrë të veçantë procesin e vaksinimit.

## Podujeva fal tatimin në pronë

Podujevë, 8 dhjetor - Komuna e Podujevës ka marrë vendim për faljen e tatimit në pronë në vlerë prej 100 eurosh për vitin 2023 për të gjithë qytetarët, ka bërë me dije kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi. Ai ka thënë se për të gjithë qytetarët të cilët tashmë e kanë paguar tatimin, vlera e falur iu llogaritet paradhënie për vitin 2024. “Për qytetarët të cilët tashmë e kanë paguar tatimin, vlera e falur iu llogaritet paradhënie për vitin 2024. I falënderoj asamblistët për votimin e urime qytetarëve”, ka shkruar Bulliqi në “Facebook”.



## Osmani takon Erdoganin, e falënderon për mbështetjen e fuqishme dhënë Kosovës

TURQI, 8 DHJETOR - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka takuar të premten në Stamboll presidentin turk Rexhep Tajip Erdogan. Ajo ka shkruar në “Facebook” për këtë takim, duke theksuar se Erdoganin e ka falënderuar për mbështetjen e fuqishme që po jep për Kosovën, përfshirë në periudha të rënda e sfiduese për ne, si dhe e ka informuar për zhvillimet e fundit në vendin tonë. “Do të vazhdojmë të punojmë afër në mënyrë që ta rrisim bashkëpunimin mes vendeve tona e popujve tanë”, ka shkruar Osmani në “Facebook”.



# “Keqpërdorimi i marrëveshjeve për shërbime të veçanta në nivelin qendror”

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Demokraci Plus ka publikuar raportin “Keqpërdorimi i marrëveshjeve për shërbime të veçanta në nivelin qendror”. Sipas këtij raporti, lidhja e marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV), në fakt keqpërdorimi i tyre, është trajtuar në këtë raport si vazhdimësi e raportit të vitit 2022. “MShV-të vazhdojnë të keqpërdoren në masë të madhe nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal. Keqpërdorimet apo shkeljet më të shpeshta kanë të bëjnë me plotësimin e pozitave të rregullta në shërbimin civil përmes MShV-ve, si dhe mospërdorimin e drejtë të procedurës së rekrutimit”, thuhet në raportin e Demokraci Plus-it.

Në raportin e publikuar nga Demokraci Plus janë përfshirë gjetjet e monitorimit të lidhjeve të marrëveshjeve për shërbime të veçanta nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Zhvillimit Rajonal, Ministria për Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë, Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Ministria e Ekonomisë, për të cilat janë analizuar kontratat për shërbime konsulente, ndërsa për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike (KOSTT), Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (AShNA) dhe Postën e Kosovës janë analizuar kontratat për përfaqësim ligjor. “Disa nga gjetjet e raportit janë: Ministria e Financave Punëve dhe Transfereve ka shfrytëzuar procedurat e prokurimit për shërbime të veçanta, si mundësi rekrutimi për ato konkurse që i kanë dështuar; Ministria e Zhvillimit Rajonal




(MZhR) për të tretin vit me radhë kontrakton të njëjtin konsulent; Posta e Kosovës kontraktoi një kompani ligjore për punë të njëjta siç edhe ka përshkrimin Drejtoria për Çështje Ligjore në këtë kompani. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ka paraqitur kërkesa minimale lidhur me përvojën e punës për të kontraktuar ekspertë/konsulentë”, thuhet në raport.

Në këtë drejtim Demokraci Plus rekomandon se institucionet duhet ta ndalojnë punësimin e personave për punë rutinore në zyrë/departamente/drejtori në emër të nevojës për konsulentë apo ekspertizë për punë specifike; të bëhet risistematizimi i stafit nëpër institucione duke analizuar nevojat për staf shtesë konform përgjegjësive që kanë; dhe mungesa e stafit nëpër institucione duhet të adresohet në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) e cila është përgjegjëse për administratën publike.

# Tahiri: Draft-statuti i Asociacionit ka disa probleme serioze, duhet të adresohen në Kushtetuese

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Kryesia e AAK-së ka zhvilluar një diskutim me tone shumë kritike për draft-statutin e Asociacionit. Janë shprehur shqetësimet për përmbajtjen e tij, veçanërisht për referimin në Rezolutën 1244, komisionin e arbitrazhit, si dhe raportin paralel të Asociacionit me institucionet e pushtetit qendror.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se draft-statuti i Asociacionit ka disa probleme serioze që duhet të adresohen në Kushtetuese. “Në takim i paraqita komentet e mia në një dokument prej tetë faqesh, duke theksuar se ky Statut ka



disa probleme serioze të cilat duhet të adresohen në Gjykatën Kushtetuese. Neni 42, Komisioni i Arbitrazhit, është i papranueshëm. Arsimi dhe shëndetësia si dhe çështjet sociale duhet të rihartohen/përmirësohen nga Gjykata Kushtetuese dhe ‘Super struktura’ të dobësohet, sepse ashtu siç është tani, kjo strukturë organizative është shumë e fuqishme. Në fakt, kjo strukturë me këto organe nuk i ngjan Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, as modeleve evropiane të asociacioneve”, ka treguar Tahiri. Sipas tij, në një pjesë të konsiderueshme të këtij dokumenti gjuha është politike me dykuptimësi dhe mundësi interpretimi të dyfishtë nga palët. “Në vlerësimin tim ky është një statut që në mënyrë të sofistikuar ka inkorporuar kompetenca tepër përmbajtjesore. Shpresoj që Gjykata Kushtetuese ta bëjë punën e vet”, ka thënë Tahiri.

Partitë opozitare në Kosovë kanë pranuar draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nga Bashkimi Evropian të cilin Kosova tashmë e ka pranuar. Draft-statuti i Asociacionit i është paraqitur fillimisht kryeministrit Albin Kurti gjatë vizitës së pesëshes evropiane në Prishtinë gjatë muajit tetor, e ku ishte i pranishëm edhe i dërguari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak.

## Qeveria mban mbledhje elektronike, merr disa vendime

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Qeveria e Kosovës të premten ka zhvilluar një mbledhje elektronike në të cilën ka miratuar disa vendime. Në njoftimin për medie bëhet me dije se janë rialokuar 320 428.00 euro për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në shërbim të zbatimit të Programit “Masat preventive - intervenime emergjente” nëpër komuna të ndryshme.

Po ashtu, është miratuar vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme, të konfiskuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR Nr. 1046/16, në shfrytëzim për Odën e Ndërmjetësuesve të Kosovës.

Qeveria, po ashtu, ka aprovuar vendimin për të kërkuar nga presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj.



# OShP-ja është përballur me probleme të mosfunksinonimit të plotë të bordit




Prishtinë, 8 dhjetor - Iniciativa për Progres (INPO) nëpërmjet tryezës së diskutimit ka publikuar raportin "Shqyrtimi i korrupsionit në prokurim publik" në të cilin raport janë shpalosur të gjeturat nga monitorimi i punës së OShP-së për periudhën janar - shtator 2023.

Qëllimi kryesor i kësaj tryeze ishte nxitja e debatit konstruktiv përmes gjetjeve të raportit i cili trajton punën e Bordit të OShP-së, gjegjësisht paneleve shqyrtuese në zgjedhjen e lëndëve të ankesave gjatë periudhës janar - shtator 2023.

Drejtoresha ekzekutive e INPO-s, Albulena Nrecaj, në fjalën e saj ka bërë një përmbledhje sa i përket qëllimit të këtij raporti. Ajo ka thënë se INPO gjatë monitorimit të prokurimit është ballafaquar shumë herë me pamundësi për t'i monitoruar aktivitetet e prokurimit duke pasur parasysh se ato ishin të bllokuara në OShP dhe kjo ka qenë një nga arsyet dhe shqetësimet që INPO ka ngritur dhe ka diskutuar se ku po qëndron problemi dhe pse ka kaq shumë vonesa. "Gjatë monitorimit INPO ka vërejtur që OShP-ja gjatë vitit 2023 ka ndryshuar rregullat e 'lojës' në kuptimin që ka ndryshuar rregullat e punës ku ka bërë ndryshime në rregullat e paneleve shqyrtuese. Në të kaluarën, saktësisht me rregulloren e vitit 2020 të punës, panelet shqyrtuese individuale trajtonin vetëm lëndët e ankesave deri në vlerën 30 000.00 euro, ndërsa nga muaji gusht deri më tani kjo vlerë është rritur 900 %, ku në panele individuale ishte vendosur që lëndët e ankesave deri në vlerën 300 000.00 euro të trajtoheshin", ka thënë Nrecaj.

Raporti është paraqitur nga monitoruesi Arbër Kabashi, i cili ka ofruar të dhëna të hollësishme si dhe të dhëna statistikore rreth trajtimit të ankesave të deponuara deri më 30 shtator 2023. "Raporti ka vërë në pah se OShP është përballur me probleme të mosfunksinonimit të plotë të bordit dhe se ndryshimet e rregullave nuk kanë rezultuar me rritje të efikasitetit të punës së paneleve shqyrtuese, por kanë shkaktuar regres në proces sepse, sipas analizës, ndryshimet e rregullores janë bërë në kundërshtim me LPP-në. Raporti parasheh një mori të rekomandimeve për institucionet e vendit si Qeveria dhe Kuvendi për t'i implementuar obligimet dhe kompetencat e tyre kushtetuese dhe ligjore për përmirësimin e këtyre problematikave që janë dukuri negative për shoqërinë. INPO me këtë rast ka nënvizuar nevojën e sigurimit që shqyrtimi i ankesave të kryhet brenda afateve ligjore", ka theksuar Nrecaj.

# Bankat në Kosovë fituan mbi 140 milionë euro deri në tetor

Prishtinë, 8 dhjetor - Vetëm nga janari deri në muajin tetor 2023 bankat komerciale në Kosovë kanë arritur t'i shtojnë fitimet e tyre për gjithsej 141 milionë euro. Për vetëm një muaj të njëjtat kanë fituar 18 milionë euro pasi deri në fund të shtatorit profiti i tyre ishte 123.7 milionë euro. Sipas raportit të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për rrjedhën e sistemit financiar për muajin tetor të vitit 2023, të hyrat totale në këtë sektor ishin në vlerë të 357.4 milionë eurove. Prej tyre, gjithsej 265.6 milionë ishin të hyra vetëm nga interesi. Ndërsa shpenzimet totale të këtij sektori për këtë periudhë ishin 216.3 milionë, kurse shpenzimet për interes ishin në vlerë të vetëm 33.0



milionë eurove.

Ndërkohë normat efektive të interesit në muajin tetor ranë në vlerën 6.4 % nga 6.5 % sa ishte në shtator dhe 6.7 % sa ishte në muajin gusht të këtij viti. Norma e interesit për kreditë e dhëna për ekonomitë familjare në këtë periudhë mbeti 6.2 % siç ishte në shtator, kurse për ato konsumuese ra në 6.5 % nga 6.6 % sa ishte në shtator, kurse ajo për kreditë për korporatat jofinanciare ra në 6.6 % nga 670 % sa ishte në muajin shtator të këtij viti.

Në anën tjetër, vlera totale e shumës së dhënë për kredi deri në muajin tetor të këtij viti arriti në 4 miliardë e 833.9 milionë nga 4.791.1 milionë euro sa ishte vlera në shtator. Prej gjithë kësaj shume, 1 miliard e 874.3 milionë euro ishin kredi për ekonomitë familjare, 2 miliardë e 925.8 milionë të tjera për korporatat jofinanciare dhe 16.1 milionë euro për korporatat e tjera financiare.

Kurse depozitat e qytetarëve të ruajtura nëpër bankat komerciale në vend deri në fund të muajit shtator 2023 arritën në 5 miliardë e 875.9 milionë euro, nga 5 miliardë e 853.4 milionë sa ishte vlera e tyre në shtator.

Aktualisht vlera totale e aseteve të sektorit bankar në vend është 7 miliardë e 174.9 milionë euro.

Edhe gjatë vitit 2022 fitimi neto i këtyre institucioneve bankare në vend kishte shkuar mbi 140.3 milionë euro, duke e tejkaluar kështu mesataren disavjeçare që zakonisht ishte përmbyllur me nga 80-100 milionë euro.

Në vendin tonë aktualisht janë duke operuar gjithsej 12 banka komerciale, 9 prej të cilave janë banka me kapital të huaj. (Buletini Ekonomik)

# KEDS-i dhe KESCO po importojnë energji elektrike mbi 1 milion euro në ditë

Prishtinë, 8 dhjetor - Gjatë këtyre ditëve, pas ftohjes së temperaturave, është rritur edhe konsumi i energjisë elektrike. Fatkeqësisht, paralelisht me këtë ka ndodhur edhe shkurtimi i prodhimit vendor, kanë njoftuar KEDS-i dhe KESCO. "Për ta mbuluar këtë gep, pra sasinë e munguar në mes të prodhimit dhe kërkesës, KEDS dhe KESCO po detyrohen të blejnë energji elektrike në vlerë mbi 1 milion euro në ditë. Në aspektin sasior të dy kompanitë bashkërisht po importojnë mbi 7500 megavat brenda 24 orëve ose deri në 400 megavat në orë. Kjo po ndodh pasi kërkesa ka arritur në mbi 1100 megavat në orë, ndërsa prodhimi vendor nuk mund të tejkalojë më tepër se 700 megavat në orë. Pra, po importohet në kohë piku mbi 35 për qind e energjisë elektrike që konsumohet nga konsumatorët", thuhet në njoftim.

KEDS dhe KESCO kanë theksuar se prodhimi aktual është më i ulët se bilanci elektroenergjetik që na ishte paraqitur. "Lidhur me këtë, ne kemi reaguar, duke kërkuar nga prodhuesi më i madh vendor, KEK-u, që t'i përmbahet planit, sepse çdo devijim nga plani, në këtë rast mbi 120 megavat në orë minus, paraqet barrë të rëndë për dy kompanitë dhe e vë në vështirësi komplet sistemin elektroenergjetik. Ky minus aktualisht po mbulohet nga KEDS dhe KESCO, pasi të dy kompanitë janë duke e përballuar këtë kërkesë të madhe për energji elektrike, por duhet të ndërmerren masa të menjëhershme nga secila hallkë e sistemit në mënyrë që të zbuten vështirësitë dhe sistemi të funksionojë më lehtë", theksohet në njoftim.

Sipas KEDS dhe KESCO, rikthimi i prodhimit të energjisë elektrike në bazë të bilancit vjetor të ofruar më herët për muajin dhjetor nënkupton më pak import dhe rrjedhimisht kosto më të ulët. "Megjithatë, është e qartë se problemi mund të bëhet më serioz nëse palët e interesuara të tregut vazhdojnë të dështojnë të përmbushin planet që kanë paraqitur më parë. KEDS dhe KESCO kërkojnë edhe nga konsumatorët që ta kursejnë maksimalisht energjinë elektrike dhe aty ku kanë mundësi të mos e përdorin për ngrohje. Përdorimi efiçient i saj nënkupton se do të mundë të kalojmë një dimër më të lehtë dhe më të përballueshëm", është theksuar në njoftimin për medie.



# Hipokrizia në formë të ftesës për opozitën e dhunuar nga pozita dhe januse presidentja!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

**Bisedime për mbetjet mortore të shtetësisë së Kosovës:** Draft-statuti për legalizimin e autonomisë politike dhe territoriale serbe në Kosovë iu dorëzua Albin Kurtit dhe Aleksandar Vuçiqit, sigurisht edhe Vojsa Osmanit, presidente personale e KM të Kosovës, Albin Kurti. Mund ta ketë pranuar edhe shërbyesi civil dhe privat i KM të Kosovës që aktualisht e luan rolin e kryetarit të Kuvendit. Opozita deklaronte se nuk e ka pranuar atë draft se... po ta pranonte, do ta bënte namin. Në takim me burokratët e BE-së, përfaqësuesit e opozitës deklaruan se vetëm iu është treguar drafti por jo edhe dorëzuar apo se iu ishte dhënë mundësia për ta lexuar. I vetmi ishte Ramushi që deklaroi se në atë takim e paska lexuar draftin... mbase kur ka shkuar në nevojtore për t'u liruar nga tretjet fiziologjike. Deputetët e partisë në pushtet, ata të LVV-së dhe këmbalecët e "Guxo" deklaruan se as ata nuk e kanë lexuar draftin por se janë të sigurt se është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe më i mirë se ai i Isës dhe Hashimit. Te Isa dhe Hashimi nuk kishte as autonomi substanciale, as arbitrazh e as shtet të kishës serbe në Kosovë. Ishte shumë e pritshme që ambasadorët dolën në mbrojtje të përputhshmërisë së Draftit me Kushtetutën e Kosovës në kohën kur njohësi më i madh i Kushtetutës së Kosovës, Enver Hasni e thotë të kundërtën, pikërisht ky draft e shkatërron shtetin unitar të Kosovës duke e federalizuar atë dhe duke e përjashtuar Kushtetutën e Kosovës nga ky proces për faktin se po krijohet një kushtetutë e re për autonominë substanciale të serbëve në Kosovë, Kushtetuta Materiale. Një rol shumë agresiv dhe të pandershëm e ka marrë mbi vete ambasadori Rohde i cili është edhe më ekstrem se vet shefi i Zyrës për Kosovën, gospodin Petkoviq. Ambasadori Rohde, po e shkel rënd Traktatin e Vjenës që e rregullon fushëveprimin e personelit diplomatik duke ndërhyrë në çdo proces në Kosovë. Po të ishte në Serbi, moti do t'i caktoheshin 24 orë, kohë e mjaftueshme për t'i mbledhur plaçkat dhe rregëzinat për t'u kthyer në Gjemani. Edhe ambasadorët Bosch dhe Delawie ndryshe flisnin sa ishin ambasadorë, krejt ndryshe flasin sot. Ambasadori Rohde po e mirëpërdorë (për nevoja personale dhe të shtetit që e përfaqëson e sidomos për nevoja të Serbisë llaskucërinë e politikanëve të tashëm në Kosovë). Ky është mandati i tij me të cilin është ngarkuar aktualisht. Ky draft-statut mund të jetë 100 për qind në përputhje me Kushtetutën e Gjermanisë por në asnjë mënyrë me Kushtetutën e Kosovës. Po Rohde, në mesin e të kastruarve nga përgjegjësia shtetërore dhe kombëtare nuk e ka vështirë ta luaj rolin e Don Zhuanit. Nëse ky draft-statut pranohet si i tillë (Albini e ka pranuar) Kosova do t'i ketë vetëm dy mundësi, e para të hyjë në një raport federal apo konfederal me Serbinë dhe, e dyta, me një ndryshim të kufijve në Ballkan, të bashkohet me Shqipërinë. Mundësi të tretë nuk ka.

**Januse presidentja dërgon ftesa për opozitën:** Vojsa Osmani u bë presidente duke fituar votat e deputetëve të Listes Serbe që ishin përcaktuese. Po të mos ishin ato vota, as që do të ishte cucur në postin e presidentes. Sipas Kushtetutës së Kosovës presidenti /ja ka rol unifikues ndërsa kjo unifikimin e ka bërë vetëm duke iu nënshtruar pa asnjë kusht kryeministrit të Kosovës. Ndaj opozitës ka pasur qëndrim jashtëzakonisht urrejtës përjashtuar këtu LDK-në të cilën e ruan si strehë nga breshëri që eventualisht mund ta dëmtojë gjatë ecjes rrugës presidenciale. Kishte dhe ka urrejtje patologjike ndaj pengjeve që po mbahen në Burgun e Hagës, pararendës që ia mundësuan të jetojë e lirë, të jetojë në një shtet të lirë dhe, për fat të keq të bëhet edhe presidente, pa e dhënë as edhe një kontribut të vetëm, personalisht dhe familjarisht. Me Albinin u bënë Boni dhe Klajdi i politikës që po e gërryejnë shtetin dhe shtetësinë e Kosovës përmes lëshimeve e që po shpërfaqen, deri tash fshehtas në formën e draft-statutit. Thyen duar, këmbë dhe dhëmbë për ta kapur Këshillin Prokurorial, Këshillin Gjyqësor, Policinë e Kosovës, AKI-në, Mendermethënë Akademinë e Shkencave dhe të Arteve, Diplomacinë dhe segmentet e tjera shtetërore. Në shumicën e rasteve ia dolën. Bënë biseda të fshehta rezultatet e të cilave po dalin në formën dhe përmbajtjen e draft-statutit. Kurrë dhe në asnjë rast nuk i është drejtuar qytetarëve të Kosovës për përmbajtjen e këtyre bisedimeve duke i përjashtuar nga vendimmarrja për fatin dhe ardhmërinë e tyre. Duke shfrytëzuar resurset shtetërore filloi ta mësojë gjeografinë, duke vizituar shtete dhe vende ekzotike për të cilat as që e ka ditur se ekzistojnë. Personalisht kam qenë për ndryshim duke e përkrahur për presidente. Mirëpo, në asnjë mënyrë nuk kam besuar se për moshën që e ka ta shpërfaq një urrejtje patologjike ndaj themeluesve, bartësve dhe formuesve të shtetit të Kosovës që tash po mbahen si pengje në Burgun e Hagës për të cilët kurrë nuk e ka treguar asnjë interesim. Përveç se është angazhuar që t'ua bëjë situatën më të rëndë. U bë pjesë e përdhunimeve sadiste të opozitës përmes injorimit të saj duke treguar interes vetëm kur ka pasur interes personal të saj dhe kur është dashur të paraqitet si sozi e Albinit. Është e padiskutueshme që Albini këtë e sjell në gisht sikur që e sjell LVV-ja dhe një pjesë të opozitës. Tash, po kërkon të takohet me opozitën që të ndërtohet një konsensus për pajtim me Draft statutin që siguron autonomi substanciale ndonëse ky draft-statut është pranuar nga Albin Kurti e që nënkupton se refleksivisht është pranuar edhe nga Vojsa Osmani. Kryetarin e Kuvendit nuk e pyet kush as kah e ka dhija bishtin e lëre më për ndonjë çështje politike. Vojsa Osmani, me sjellje emocionalisht të papërpunuar dhe të papërfunduar e ka sakatosur edhe stafin e saj e lëre më që do ta kursejë opozitën. Vjosa Osmani nuk ka asnjë të drejtë të thërras opozitën për konsultim për një draft që është pranuar që më parë. Është ky veprim janusian, dyfytyrësh, me një fjalë. Së pari, nuk ia kërkon Kushtetuta dhe, së dyti është kjo punë e Kuvendit të Kosovës ku do të diskutohej për një dokument të pranuar që më parë. Nuk e ka Vojsa Osmani sikletin për veten e saj por do t'i sigurojë Albinit një strategji dalëse nga kjo situatë, të blejë kohën dhe ta racionalizojë helmin (m...) që do ta hanë politikanët dhe që do ta hamë edhe ne, qytetarët e Kosovës për faktin që nuk po i kundërshtojmë por që fatin e vendit ua kemi lënë në duar projugosllavëve dhe proserbëve në me krye patriotin e madh jugosllav Jeton Qurroin dhe hajnat e atyre që kinse e monitorojnë arsimin duke e sulmuar një analfabete, si ministren aksidentale aktuale. Për ta përkrahur draft- statutin janë mobilizuar edhe sekseri i Qurroit, ambasador në Bruksel që u shqua si lehës i partisë në pushtet me lehje prej baritoni deri sa partia e mori pushtetin. Po angazhohen gazetarë që dikur, jo fort moti shkruanin se propozimi që e ka pranuar Albini është një arkmort për Kosovën ndërsa tani shkruajnë se nuk ka më të mirë. Ky farë sekseri dhe lehës me zë prej baritoni, me urdhër të një injoranteje që merr guxim ta quaj veten dhe prezentohet si ministre për punë të jashtme e angazhoi një karikaturë si këshilltar për përfaqësim të karikaturave të pushtetit për një rrogë modeste prej 7500 euro në muaj plus shpenzimet modeste për bileta aeroplani me klasë biznesi apo detyrimi që të bëjnë gjumin e natës në bujtina si ësht hoteli Ric apo Valdorf Astoria. Të poshtër, skajshmërisht të poshtër. Në kontekst të ndërtimit të një infrastrukture për moskundërshtim të draft-statutit është edhe ftesa për takim me opozitën. Po, opozita, çka do të bëjë opozita?

LDK-ja është deklaruar se ftesa është e vonuar ndonëse tërë kohën ka qenë në anën e presidentes Osmani duke komunikuar me të dhe duke u këshilluar për: "çështjet me rëndësi të veçantë për shtetin, kombin dhe shokun Albin .." Në të kundërtën do ta dërgonte këtë presidente në Gjykatën Kushtetuese për shkeljet e shumta që i ka bërë pas së cilave, pa asnjë dyshim do të gatuante petulla në njërën nga shtëpitë që i ka. LDK-ja, bashkë me Avokatin e Popullit kanë qenë "Engjëlli mbrojtës dhe rrufepritës "i Vjosa Osmanit nga rrufetë e Gjykatës Kushtetuese. PDK-ja nuk ka asnjë motiv ta takojë presidenten Osmani përveç nëse kjo nuk shoqërohet nga badigardët e fuqishëm ndërkombëtar, të veshur me petkun e ambasadorit. AAK-ja besoj se shkon, është parti shtetformuese në të cilën absolutisht interesat e përgjithshme mbizotërojnë mbi atro personale. Madje, në AAK-ja nuk mund ta gjeni as një të vetëm që udhëhiqet nga interesat personale. Në Kosovë, për fat të keq nuk ka opozitë aktive ndonëse janë njëqindmijë arsye për një opozitarizëm më aktiv. LDK-ja, po bënë opozitë oportuniste, opozitë përshtatëse duke ia bërë me sy Albinit, përmes syzeve të Vojsa Osmanit se, ja ku jemi, mund të bëhemi bashkë në funeralin e varrimit të shtetit të Kosovës përkatësisht të bëhen pjesë e koalicionit. AAK-ja ka pak vota që e tundojnë Albinin që t'ua shkelë pak syrin ndërsa edhe "meshqit që dikur protestonin, duket se përfundimisht janë lodhur". PDK-ja ka pasur mundësi të bëjë opozitë shumë më të fuqishme por nuk e bëri. Pse, e kam të qartë unë por jo duket edhe këta të PDK-së. PDK-në e shpëtoi me fytyrë bërja e opozitarizmit kushtetues sepse e pamundësoi dhe, në disa raste sikur që e ngadalësoi në disa raste tjera kapjen absolute të institucioneve dhe të shtetit nga "kmerët e kuq, tash të aristokratizuar të LVV-së". Po të ndodhte kështu, të gjithë do të duhej të prenë dhe qethin flokët sikur që e ka shoku Albin. Problem i madh nuk do të ishte për ata që kanë flokë por për ata që kanë mungesë të flokëve. Mungesa e opozitarizmit aktiv në Kosovë do të prodhojë dy situata, pas liberalizimit të vizave një numër i konsiderueshëm do të largohet jashtë Kosovës kurse ata të vendosur të qëndrojnë në Kosovë do të zgjedhin për veprim një mundësi të dhunshme. Kosova, më lehtë do të destabilizohet nga brenda se që do të destabilizohet nga jashtë. Zgjedhje të parakohshme do të ketë vetëm në rast se LVV-ja dhe LDK-ja bëjnë një marrëveshje të fshehtë për koalicion të ardhshëm e jo shkaku i përgjegjësisë për pranim të draft-statutit.

**A po zbatohet marrëveshja?** Ar-Miku i përbetuar i Albin Kurtit, Miroslav Lajçak deklaroi se ka përparime të ndjeshme kohëve të fundit në zbatimin e marrëveshjes. Duket se Besnik rrenci dhe injoranti paska pasur angazhim (dhe honorare) shtesë për këtë. Marrëveshja po zbatohet pahetueshëm dhe larg syve të opinionit për ata që kanë problem me dioptri politike apo janë të verbër pas liderit si këta militantët e LVV-së. Pranimi i tabelave, nisma për shkarkimin e patriotit të madh Atiqit nga kryetari i Mitrovicës së Zajebnicës dhe Oso Kukës janë tregues bindës dhe dëshmi për atë të Lajçakut u thënë medieve. Pastaj, ju kujtohet se Albin Kurti ka kërkuar sekuencionimin e zbatimit të marrëveshjes që do të thotë: "ta hashë atë që nuk hahet me lugë të ilaçeve dhe jo me garuzhdë". Të gjitha këto që serbët po i pranojnë do të jenë pjesë e kompetencave të Bashkësisë së komunave serbe e jo se e pranojnë autoritetin e KM të Kosovës, Albin Kurtit apo shtetin e Kosovës. Pa lejen e Vuçiqit asgjë nuk do të bënin ndërsa Vuçiqi e di se çka do të fitojë me draft-statut. Nëse Enver Hasani, si autoritet kombëtar dhe ndërkombëtar për çështje të Kushtetutës e ka dhënë mendimin profesional, tregimi ka marrë fund. Rohde allamani mund të vendoset në krye të karvanit të injorantëve vendorë të kushtetutës, të shitur për një grusht parash, por jo edhe përballë autoritetit të Enver Hasanit. Po ta kuptonte këtë Albin Kurti, ndryshe do t'i kishte punët. Më mirë, pa asnjë dyshim!

DOLI NGA SHTYPI BOTIMI I DYTË I LIBRIT TË MR. SCI. HAMËZ S. LLADROVCIT

# "Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2022)"



MR. SCI. HAMËZ S. LLADROVCI

## PARATHËNIE PËR BOTIMIN E DYTË

Duke parë interesimin e lexuesit për librin dhe për tematikën e shtjelluar me titull: "Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe nga viti 1856 e deri në ditët e sotme", që është ende aktuale (ku kjo politikë rusomadhe në këtë shekull është bërë edhe me e theksuar, veçanërisht që nga 24 shkurti i vitit 2022, kur Federata Ruse sulmoi dhe pushtoi një pjesë të Ukrainës), vendosa që ta botoj edhe njëherë librin në fjalë. Pushtimi filloi në mëngjesin e 24 shkurtit të vitit 2022, me një arsenal të madh dhe me trupa të shumta, duke menduar që do ta pushtojë Ukrainën me një blicluftë, me qëllim që, jo vetëm ta pengojë zgjerimin e NATO-s, por edhe rrëzimin e qeverise demokratike properëndimore të Vladimir Zenelskyt. Për ta fshehur sulmin, Putini këtë agresion e quajti si: "Operacion special ushtarak". Në fakt, Putini, pasi aneksoi Krimenë, e cila ka qenë një pike kyçe gjeostrategjike e ushtarake e Rusisë, që nga viti 1856, me anë të një referendumi ajo shpall pavarësinë nga Ukraina dhe me "vullnet" do t'i bashkohet Rusisë, pra një politikë, sa djallëzore, aq edhe perfide për ta aneksuar këtë vend strategjik, që lidh Detin e Zi me Mesdheun dhe jo vetëm. Pas aneksimit të Krimesë, ajo nxiti forca reaksionare ruse, duke i furnizuar me armatim, që të bëjnë një kryengritje kundër Ukrainës, si dhe të shkëputen nga Ukraina për t'iu bashkuar Rusisë. Duke parë një rezistencë të madhe të Ukrainës, atëherë Putini vendosi ta rrëzojë Zelenskyn dhe të sjellë një qeveri kukull në Ukrainë, e cila do të jetë kundër NATO-s dhe antiamerikane. Në fjalimet e tij, Putini përkrahte publikisht qëllimet irredentiste, duke kamufluar qëllimet e veta se, kinse, Ukraina qeveriset nga një qeveri neo-naziste, e cila kinse e persekuton pakicën etnike ruse. Pas këtij fjalimi, disa minuta me vonë, filluan raketat ruse ta godasin kryeqytetin e Ukrainës dhe vendet e tjera, ku forcat e mëdha tokësore sulmuan në shume drejtime. Si kundërpërgjigje, presidenti i Ukrainas, Zelensky, mobilizoi ushtrinë me miratimin e një ligji ushtarak, ndërsa pushtimi i Ukrainës u dënua ndërkombëtarisht si e padrejte dhe shkelje e së drejtës ndërkombëtare dhe agresion i hapur e i paarsyeshëm. Një rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dënoi agresionin dhe kërkoi tërheqjen e menjëhershme të trupave ruse nga Ukraina. Po ashtu, edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, me seli ne Hagë, kërkoi që të pezullohen menjëherë operacionet ushtarake ruse në Ukrainë. Edhe Këshilli i Evropës njëzëri dënoi agresionin në Ukrainë, duke dëbuar Rusinë nga këto marrëdhënie Evropë - Rusi. Shumë vende vendosen edhe sanksione kundër Rusisë. Një gjë e tillë u kërkua edhe nga sateliti i Rusisë, Serbia, që ta bëjë një veprim të tillë për të vendosur sanksione kundër Rusisë. Por, Serbia e Vuçiqit taktizoi, duke përdorur dy fytyrat e saj, ku në Asamblenë e Kombeve të Bashkuara votoi pro dënimit të Rusisë, por nuk vendosi sanksione ndaj Rusisë sot e kësaj dite.

Bile instruksionet e Rusisë për Serbinë ishin: që të përdorë Serbia të njëjtën metodë në Kosovë, në pjesën veriore, përmes bandave kriminale të Listës Serbe, që të bojkotojnë institucionet, të bëjnë barrikadime, si dhe të bëjnë incidente politike dhe të armatosura, duke sulmuar njësitë policore të Kosovës dhe duke luajtur lojën e "viktimës" me kushtëzime për asociacionin e komunave serbe me kompetenca ekzekutive. Përmes këtyre incidenteve synohej që të ndiqet rruga e Serbisë çfarë bëri në Bosnjë e Hercegovinë, ku krijoi Republika Sërpskën atje. Pra, synohej që të realizohet i njëjti model edhe në Kosovë, vetëm sa për sy e faqe, duke zgjatur bisedimet me qëllim që, nëse Rusia fiton ndaj Ukrainës dhe Perëndimit, në bashkëveprim të destabilizojnë Ballkanin, në radhë të parë: Kosovën, Malin e Zi, Bosnjën, bile edhe Kroacinë.

Pra, këto rrethana dhe këto hulumtime shkencore nga ana ime, lidhur me gjeopolitikën ruse në Ballkan dhe në Evropë, që nga viti 1856, fatkeqësisht, dolën të sakta. Pra, që nga 1856 e deri më sot është e njëjta politike e gjeostrategji e Rusisë për zgjerimin e interesave të saj në tërë botën, ku madje, sot Rusia është bërë aleate e panatyrshme e shumë vendeve islamike, si: Irani, Siria e vendet e tjera, duke përfshirë edhe Kinën, Korenë Veriore, etj.

Pra, ky realitet dhe ky aktualitet shton vlerën e këtij libri, pasi janë fakte e realitete të vërtetuara e praktike sot në marrëdhëniet ndërkombëtare, ku paqja dhe siguria ndërkombëtare është vënë në rrezik, ku ky konflikt mund të zgjerohet edhe në vendet e tjera, me mundësinë e shpërthimit të një Lufte të Tretë Botërore, nëse Putini përdor armët bërthamore, pasi nuk po mund të realizojë synimet e dëshiruara ndaj Ukrainës dhe ndaj NATO-s. Një gjë duhet theksuar se, Rusia e menduar si superfuqi, nuk ishte dhe nuk mund të jetë as tash, por një fuqi baroti po, pasi posedon armët nukleare. Po qe se edhe një vend anëtar i NATOS sulmohet nga Federate Ruse, atëherë në bazë të Statutit të NATOS (neni 4 dhe 5) do të reagonin të gjitha vendet anëtare të NATO-s në mbështetje të anëtarit të saj të atakuar.

Urime e suksese për Ukrainën! Paqja e siguria ndërkombëtare u ktheftë në binarët e mëparshëm pasi kurrë me tepër (pas Luftës Dytë Botërore) nuk ka qenë e rrezikuar paqja e siguria deri më sot, se sa me këtë agresion rus ndaj Ukrainës!



# Himarjotët, shqiptarë apo grekë? Ja si e shpjegonte Petro Marko

Shume shoke me kane pyetur: Po ju, jeni shqiptare apo greke? Te jesh i çdo kombesie nuk eshte turp, por une u jam pergjigjur me siguri: "Jemi shqiptare!"
Nje here thirra nje mbledhje te gjere ne fshat. U mbush oborri i shkolles me burra dhe gra. Biseden e nisa pak a shume keshtu:
- Duhet ta dime mire se ç'jemi, ç'kombesi kemi, se degjohen poshte e lart fjale se keta jane greke, keta nuk dine se ç'jane. Pra fillojme: Ti shoku Pavllo Beja, nga e ke origjinen?
- Familja jone, si gjithe Gjileku, jemi krutane. Erdhem ketu pas vdekjes se Skenderbeut.
- Po ti, Vangjel Liza, si e di origjinen e familjes sate?
- Ne vijme nga Terbaçi. Ketu erdhen tre vellezer nga Terbaçi. Dhe nga tre vellezerit u shtuan lagjet Lizaj, Çaçedhimitret dhe Trekot.
- Po ju o Koste nga vini?
- Ne vijme nga Velça. Jemi nga Tavajt – dhe qeshi.
Keshtu me radhe, te gjitha familjet thane se nga rridhnin. Na doli se vetem nje ishte i huaj.

* * *

### Pra, ç'jemi ne? Shqiptare! Po pse e humbem gjuhen?

Une do te them ato qe di: Pse nenat plaka, giyshet dhe gjyshet dine me mire shqipen se greqishten? Pse qajme dhe kendojme ship? Pse fjalet e urta i themi shqip? Siç duket, që nga viti 1820 e tëhu, greqizimi u be me qellim politik nga vete Greqia, që fitoi lirine me gjakun e shqiptareve, qofte ne Mesolongji, qofte ne revolucionin grek.
Suli dhe Himara ishin shqiptare, po dy krahina autonome qe nuk njihnin as Greqine e as Shiperine, se ciles i kishte humbur edhe emri. Suli dhe Himara ishin kurdohere në lufte me turkun. Erdhi koha që Himara u nda: Himara bregdetare mbeti e lire dhe e krishtere, kurse Himara e brendshme, Labëria, Kurveleshi, Lumi i Vlores e Dukati u myslimanizuan dhe u ndane.
Megjithese u ndanë në dy fe, nuk e humben kurre lidhjen e gjakut dhe te fisit. Çdo fshatar kishte te tijte ne nje fshat te myslimanizuar qe ne kohen e Ali pashe Tepelenës. Kur beheshin operacione ndeshkimore nga turqit, bregasit nuk shkonin me pertej maleve, ne Mesaplik e ne Kurvelesh, per t'u mbrojtur, siç benin gjer ne ate kohe, por iknin me varka per ne Korfuz ose per ne Gjirit, nen mbrojtjen e venecianeve.
Aty shkonin pleq e plaka dhe femije. Burrat luftonin. Aty rrinin shume vjet, gjersa mbaronin operacionet ndeshkimore. Thone se banoret e Dhermiut shkonin ne ishullin grek, kurse ata te Himares ne Gjirit. Prandaj dhe, kur flasin greqisht, dhermijasit flasin si korfjatet, kurse himarjotet, si gjiritlinjte.

*(Marrë nga "Intervistë me veten")*



# Një trashëgimi komplekse, që ndez debat edhe pas gjysmë shekulli

Henry A. Kissinger, i cili vdiq të mërkurën në moshën 100 vjeçare, ishte një nga shtetarët më të rëndësishëm në historinë e SHBA. Megjithëse triumfet e tij më të mëdha ndodhën gjysmë shekulli më parë, trashëgimia e tij është komplekse, e debatuar dhe përmban mësime tejet informuese për sfidat e ndërlikuara të politikës së jashtme sot.
Në më pak se katër vjet gjatë fillimit të viteve 1970, Kissinger ndërmjetësoi hapjen e marrëdhënieve midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës, tërheqjen e trupave amerikane nga Vietnami, marrëveshjet kryesore të kontrollit të armëve me Bashkimin Sovjetik dhe marrëveshjet izraelito-arabe, që bënë Shtetet e Bashkuara fuqinë dominuese në Lindjen e Mesme.
Ndërsa forconte dhe mbronte këtë politikë të "zbutjes" – zbutjen e tensioneve me Bashkimin Sovjetik – Kissinger ndoqi gjithashtu atë që ai e konsideronte si një garë me shumën zero për ndikimin global me sovjetikët, duke çuar në atë që ai dikur e përshkroi privatisht, në fund të jetës, si arritja që e bënte më krenar: negocimi i marrëveshjeve midis Izraelit dhe Egjiptit dhe Izraelit dhe Sirisë pas luftës së vitit 1973.
Në vend që të mbështetej në forume shumëpalëshe, sekretari i atëhershëm i shtetit shpiku "diplomacinë e vajtje-ardhjeve" dhe ndërmjetësoi personalisht marrëveshjet, të cilat patën përfitimin e përjashtimit të Moskës. Pas kësaj, një prani dikur e frikshme sovjetike në Lindjen e Mesme u zbeh dhe Shtetet e Bashkuara u bënë fuqia arbitër e



rajonit – gjë që ka vazhduar deri në shekullin e 21-të.
Triumfet e Kissingerit, ashtu si dhe gabimet e tij, erdhën nga përqafimi i një shkolle realiste të politikës së jashtme. Ashtu si burrështetasi austriak Klemens von Metternich, i cili formësoi rendin pas Napoleonit në Evropë dhe ishte subjekt i temës së disertacionit të doktoraturës së tij në Harvard, Kissinger besonte se paqja arrihej më së miri duke balancuar interesat e shteteve të mëdha. "Ne lëvizëm drejt Kinës për të formuar një ekuilibër global," shkroi ai. "Nuk ishte për të bashkëpunuar kundër Bashkimit Sovjetik, por për të na dhënë një pozicion ekuilibrues, për ta përdorur për qëllime konstruktive – për t'i dhënë çdo fuqie komuniste një aksion, përmes marrëdhënieve më të mira me ne." Në të vërtetë, edhe kur orkestroi vizitën historike të Presidentit Richard M. Nixon në Kinë në vitin 1972, Kissinger po vuloste një marrëveshje historike me Moskën, e cila kufizon armët strategjike bërthamore.
Në vitin 1978, një editorial i Washington Post përshkroi atë që shumë nga kritikët e Presidentit Jimmy Carter mendonin se i mungonte politikës së jashtme të Carter: "ndjenja e dizajnit, e arkitekturës, e të diturit se çfarë po bënte, që Henry Kissinger e përcolli gjerësisht, madje edhe për qortuesit e tij".
Kishte shumë të tillë. Në ndjekjen e pamëshirshme të atyre që i perceptonte si interesa të SHBA-së, ai u akuzua për zbutjen me diktatorët dhe nxitjen e krimeve të luftës. Kissinger mundësoi dhe inkurajoi disa nga shkeljet më të rënda të Niksonit, duke përfshirë bombardimin e fshehtë të Kamboxhias. Ai gjithashtu mbështeti një përpjekje të SHBA për të rrëzuar presidentin e zgjedhur socialist të Kilit dhe mbështeti sulmin e përgjakshëm të Pakistanit në Bangladesh.
Edhe pse e kuptoi që përpara se t'i bashkohej administratës së Nixon-it në vitin 1969 se Shtetet e Bashkuara nuk mund ta fitonin luftën në Vietnam, Kissinger mbështeti vazhdimin e saj për vite me radhë, në emër të ruajtjes së "besueshmërisë" së SHBA-së përballë sovjetikëve. Marrëveshja e vitit 1972 që ai negocioi për tërheqjen e trupave amerikane ishte krijuar për të shpëtuar prestigjin amerikan duke ofruar një "interval të mirë" midis asaj shkëputjeje dhe kolapsit të pashmangshëm të Vietnamit të Jugut. Kur erdhi fundi në vitin 1975, Kissinger u ofrua që t'a kthente Çmimin Nobel për Paqen që i ishte dhënë.
Të vësh re gabimet e tij nuk do të thotë të minimizosh rëndësinë e Henry Kissingerit, por ta vërtetosh atë. Diplomacia e tij krijoi skenën për disa nga zhvillimet më të rëndësishme të fundit të shekullit të 20-të: shembja e Bashkimit Sovjetik; transformimi i Kinës në një fuqi globale, e nxitur nga ulja më e madhe e varfërisë në historinë njerëzore; ngatërresa e thellë e Shteteve të Bashkuara në Lindjen e Mesme. Në të vërtetë, kulmi i Kissingerit ishte një kohë kur sekretari i shtetit mund të bënte ujdi të mëdha, që duken të paarritshme për liderët amerikanë sot. Një kohë e tillë duket shumë e largët. Në vitet e tij të mëvonshme, Kissingeri komentoi për çështjet e jashtme, por kaloi shumë kohë duke u përballur me premtimin – dhe rreziqet – e inteligjencës artificiale. Por edhe nëse mundësitë për diplomaci gjithëpërfshirëse duken më të pakta, trashëgimia e Kissingerit përmban mësime si kurrë më parë. Njëri është se politika e jashtme e SHBA-së e praktikuar duke injoruar vlerat demokratike mund të arrijë shumë – por edhe të humbasë shumë. Gjysmë shekulli më vonë, Shtetet e Bashkuara janë ende duke luftuar për të përcaktuar marrëdhëniet e tyre me regjimin kinez.
Praktikat ekonomike grabitqare të Pekinit dhe të dhënat e tmerrshme të të drejtave të njeriut mbeten të neveritshme për interesat dhe vlerat e SHBA. Megjithatë hapja e Kinës ishte një hap thelbësor në ndërtimin e prosperitetit modern; shkëputja radikale do të ndëshkonte ekonomitë në të dy anët e Paqësorit dhe do të komplikonte luftën globale të ndryshimit të klimës.
Udhëheqësit e sotëm duhet të bëjnë marrëveshje kur është e mundur moralisht dhe praktikisht – por me kujdes dhe qartësi morale. Siguria vjen edhe nga ruajtja e lidhjeve me ata që ndajnë vlerat e SHBA-së, pjesërisht duke respektuar dhe rinovuar institucionet globale të ndërtuara nga gjeneratat e mëparshme. Në planin afatgjatë, natyra e regjimeve ku Shtetet e Bashkuara angazhohen ka shumë rëndësi, jo thjesht për të parë se si ekuilibrohet për momentin politika e fuqive. / The Washington Post – Bota.al




Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Përballje interesante në elitën e basketbollit

**Suharekë, 8 dhjetor** - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e 12-të në Prince Caffe Superligën e Kosovës në basketboll. Ndeshja e parë e kësaj jave do të zhvillohet mes Golden Eagle Yllit dhe Vëllaznimit. Të dyja skuadrat janë në formë të lartë. Therandasit në gjashtë ndeshjet e fundit kanë pesë fitore, kurse kuqezinjtë në shtatë ndeshjet e fundit kanë gjashtë fitore. Tani të dyja skuadrat kanë nga gjashtë fitore dhe pesë humbje, duke kërkuar fitoren e shtatë në këtë edicion. Dueli i dytë i së shtunës është ndërmjet skuadrave me traditë në basketbollin e Kosovës, Bashkimit dhe Sigal Prishtinës. Prizrenasit kanë katër fitore e shtatë humbje, kurse prishtinasit gjashtë fitore dhe pesë humbje. Të dielën Istogu do të ndeshet me Pejën. Istogasit kanë një fitore e dhjetë humbje, ndërsa kampionët e Kosovës tani renditen në vendin e dytë me tetë fitore dhe tri humbje. Ndeshja e fundit e kësaj xhiroje është ndërmjet Trepçës dhe Proton Cable Prizrenit. Mitrovicasit janë në vendin e parë me nëntë fitore e dy humbje, kurse prizrenasit kanë katër fitore dhe shtatë humbje.

**SUPERLIGA - Java 12**

**Të shtunën takohen:**
17:00 Golden Eagle Ylli-Vëllaznimi
19:00 Bashkimi-Sigal Prishtina

**Të dielën takohen:**
17:00 Istogu-Peja
19:00 Trepça- Proton Cable Prizreni



# Kompletohen 16 ekipet e mbetura në garë për Kupën e Kosovës

**Ferizaj, 8 dhjetor** - Dinamo e Ferizajt është skuadra e fundit që ka siguruar kalimin në fazën e 1/8-tës në Kupën e Kosovës, duke kompletuar 16 ekipet e mbetura në garë për trofeun. Dinamo shënoi fitore ndaj Vushtrrisë me rezultat minimal 1-0 me golin e vetëm të shënuar në minutën e 73-të nga Drilon Sadiku. Me këtë fitore Dinamo u bashkohet skuadrave të kualifikuara në fazën e 1/8-tës në Kupën e Kosovës. Të mërkurën pjesëmarrjen në 1/8-të e finales e kanë siguruar Drita, Ballkani,




Feronikeli '74, Dukagjini, Prishtina, Llapi, Gjilani, Malisheva, 2 Korriku, Vëllaznimi, Trepça '89 dhe Rilindja. Të enjten ishin tri ndeshje, ku u kualifikuan edhe Prishtina e Re, Suhareka dhe Vjosa. Shorti për ndeshjet 1/8 të Kupës së Kosovës në futboll do të tërhiqet me datë 12 dhjetor (e martë) nga ora 12:00 në selinë e FFK-së. Ndeshjet e kësaj faze pritet të zhvillohen në fillim të shkurtit, atëherë kur fillon sezoni pranveror në futbollin e Kosovës.

## SHKURT

### 'Dardanet' U19 mësojnë rivalet e rrethit të dytë në Ligën B

Në selinë e UEFA-s në Nion është bërë tërheqja e shortit edhe për rrethin e dytë të kualifikimeve për Kampionatin Evropian 2024 për vajza për grupmoshën nën 19-vjeç. Përfaqësuesja e Kosovës U19 e udhëhequr nga Albina Rrahmani do të marrë pjesë në Ligën B të këtyre kualifikimeve, ndërsa në shortin e sotëm është përfshirë në Grupin B3 ku bëjnë pjesë edhe Izraeli, Gjibraltari dhe Luksemburgu. Ndeshjet e këtij grupi do të zhvillohen në pranverë, ndërsa vendi nikoqir pritet të vendoset javën e ardhshme nga UEFA.

### Sot tri, nesër dy ndeshje në Superligë

Prishtinë, 8 dhjetor - Në fundjavë do të zhvillohen ndeshjet e javë së 17 në Superligën e Kosovës në futboll. Sot (e shtunë) zhvillohen tri ndeshje në mesin e të cilave edhe derbi në mes të Llapit dhe Ballkanit. Malisheva e pret skuadrën e Lirisë, ndërsa Prishtina ka punë me rivalët e Fushë-Kosovës. Të dielën zhvillohen dy ndeshjet e tjera. Do të ballafaqohen në derbin e Anamoravës, Gjilani dhe Drita, kurse Feronikeli takohet me Dukagjinin e Klinës. Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 13:00.

### Kosova U17 mëson kundërshtarët në Ligën A për 'Euro 2024'

Në selinë e UEFA-s në Nion është bërë tërheqja e shortit për rrethin e dytë të Ligës A për kualifikimet e Evropianit 2024 për femra në grupmoshën deri 17 vjeç. Në këtë rreth merr pjesë edhe Përfaqësuesja e Kosovës, e cila në muajin tetor arriti ta fitojë grupin e saj në Ligën B, duke avancuar në Ligën A. Në shortin e sotëm Kosova u tërhoq në Grupin A2, ku bëjnë pjesë edhe Finlanda, Portugalia dhe Islanda. E pranishme në tërheqjen e shortit ishte përzgjedhësja e kësaj grupmoshe, Sanije Krasniqi. Ky rreth i garave përbëhet nga 7 grupe. Ndeshjet zhvillohen në pranverë, ndërsa fituesit e secilit grup i bashkohen Suedisë si nikoqire e Kampionatit Evropian, i cili mbahet prej 5 deri më 18 maj. Skuadrat që përfundojnë në vendin e katërt do të bien në Ligën B për edicionin e ardhshëm kualifikues 2024/25.

## Ademi bën homazhe te shtatorja e Erion Kajtazit

MITROVICË, 8 DHJETOR - Presidenti Agim Ademi ka bërë të premten homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule te shtatorja e ish-futbollistit të Trepçës '89 dhe Përfaqësueses së grupmoshave të Kosovës, Erion Kajtazi në Mitrovicë. Kjo shtatore u përurua më 3 dhjetor në njëvjetorin e ndarjes së tij nga jeta. Kreu i FFK-së gjatë nderimit që i bëri talentit të futbollit të Kosovës ishte i shoqëruar nga babai i Erionit, Fatoni dhe përfaqësuesi i Trepçës '89, Arsim Islami. Erion Kajtazi ndërroi jetë një vit më parë pas një sulmi në zemër gjatë ndeshjes A&N - Trepça'89 në Superligën e Juniorëve. Me këtë rast presidenti Ademi edhe një herë vlerësoi talentin e jashtëzakonshëm të Erionit, teksa theksoi se shtatorja e tij do të shërbejë si frymëzim për gjeneratat e reja. Erioni ishte një prej talentëve më të mëdhenj të futbollit të Kosovës dhe vlerësohej futbollist me potencial të jashtëzakonshëm.



# Broja: Idhulli im është Cristiano Ronaldo



LONDËR, 8 DHJETOR - Nga shumëkush konsiderohet një prej talenteve më të mëdhenj që ka prodhuar futbolli shqiptar. Bëhet fjalë për "bomberin" e Chelseas, Armando Broja, i cili, pas rikuperimeve nga dëmtimet, ka filluar të kthehet në një protagonist te "Blutë e Londrës", ku i mungon vetëm gjetja e rrugës së rrjetës. Gjatë një interviste të zhvilluar para një viti për "The Players' Tribune", Broja ka treguar edhe për idhullin e tij dhe të babait të tij, me të dy, që janë tifozë të Ronaldos, por babai është i "Fenomenit", ndërsa Broja pa diskutim, i pesë herë fituesit të "Topit të Artë", Cristiano Ronaldo dhe të enjten që sapo lamë pas Broja ka përshkruar idhullin e tij. "Kam një pyetje të shpejtë për ty. Përshkruaj Cristiano Ronaldon me tri fjalë", e pyeti drejtuesi i njohur Mario Delano dhe "bomberi" nga Malësia e Madhe e ka dhënë në mënyrën më të thjeshtë të mundshme përgjigjen, teksa tha se për të Ronaldo është "më i madhi i të gjitha kohëve, i pabesueshëm, madhështor". Ndërkaq, kujtojmë se Broja vazhdon të fitojë minuta gjithnjë më të shumta në skuadrën e argjentinasit Mauricio Pochettino, këtë sezon, pas rikthimit nga dëmtimi i rëndë në gju, teka në përballjen ndaj Chelseas u aktivizua në minutën e 77 në vend të Mudryk, në "Old Trafford" të mërkurën dhe në ata pak minuta që ishte në fushë, goditi edhe shtyllën e kamerunasit Onana.

# LA Lakers dhe Indiana Pacerc do të luajnë në finalen e madhe të Kupës NBA




LOS ANXHELOS, 8 DHJETOR - Los Angeles Lakers dhe Indiana Pacers do të luajnë në finalen e Kupës inauguruese të NBA-s për një çmim prej 7.5 milionë dollarësh. Lakers mundi mbrëmë në gjysmëfinale New Orleans Pelicansin me rezultat 133-89 falë paraqitjes brilante të yllit kryesor LeBron James. LeBroni e përfundoi ndeshjen me 30 pikë, 5 kërcime dhe 8 asistime në vetëm 23 minuta në parket, dhe Austin Reaves (17 pikë), Anthony Davis (16 pië), Taurean Prince (15 pikë), D'Angelo Russell (14 pikë) dhe Rui Hachimura (12 pikë). Në anën tjetër, Trey Murphy ishte më efektivi me vetëm 14 pikë, të cilat rezultuan të pamjaftueshme për ta bërë konkurruese skuadrën e tij. Indiana mundi Milwaukee me rezultat 128-119 falë 27 pikëve dhe 15 asistimeve të Tyrese Haliburtonit dhe 26 pikëve dhe 10 kërcimeve të Myles Turnerit. Në Milwukaee, Giannis Antetokounmpo shkëlqeu me 37 pikë dhe 10 kërcime, por nuk mjaftuan për fitore. Finalja mes Lakersit dhe Indianas do të luhet në Las Vegas të dielën, më 10 dhjetor, në orën 2:30 të mëngjesit. Çdo lojtar në ekipin fitues do të marrë gjysmë milioni dollarë, ndërsa çdo lojtar në ekipin humbës do të fitojë 250 000 dollarë.

SHKURT

### Pas Zvicrës, Shqipëria pritet të përballet në miqësore me Turqinë

Fati nuk ishte me Shqipërinë në shortin e "Euro 2024", që vendosi "kuqezinjtë" në një grup "ferri" bashkë me Spanjën, Italinë dhe Kroacinë. Rivalë shumë të fortë dhe për të qenë gati për t'i përballuar ata, Sylvinho duhet ta përgatisë skuadrën "kuqezi" në mënyrën më të mirë. Për këtë arsye kundërshtarët në miqësoret e marsit duhet të jenë të të njëjtit nivel. Federata Shqiptare e Futbollit po punon në këtë linjë, ndërsa është në bisedime me disa federata të tjera evropiane. Zvicra është një kundërshtare e mundshme, me palët që nisën kontaktet menjëherë pas shortit në Hamburg. Ndërkohë, një tjetër rival për miqësoret e marsit në datat e lira të FIFA mund të jetë edhe Turqia. Nga tratativat ende nuk ka dalë "tymi i bardhë", ndërsa nuk përjashtohet mundësia edhe për një tjetër emër të madh të futbollit, që të jetë në të njëjtin nivel me Spanjën apo Italinë. Ndërkohë, pas zyrtarizimit të kampit bazë, ku do të qëndrojë kombëtarja kuqezi gjatë aventurës në "Euro 2024", Sylvinho dhe bashkëpunëtorët e tij në Federatë po punojnë për hartimin e programit të plotë stërvitor.

### Arrestohet ish-futbollisti i Malit të Zi

Ish-futbollisti malazez Simon Vukçeviç është arrestuar në pikën kufitare Gostun ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi. Mediet raportojnë se 37-vjeçarit i është gjetur një pistoletë me 126 plumba. Ish-mesfushori është dënuar me 30 ditë paraburgim në Prokurorinë e Lartë në Uzhicë për armëmbajtje pa leje dhe municione luftarake. Vukçeviçi ishte një nga talentet më të mëdhenj në Malin e Zi dhe në moshën 13-vjeçare u largua nga Podgorica për te Partizani i Beogradit. Pas kësaj, ai veshi fanellat e Saturnit rus, Sportingut të Lisbonës, Bllekbërnit në Angli, Karpateve, si dhe luajti për Vojvodinën, Levadiakosin grek, Enonisin nga Qipro dhe portugezët e Çavezit. Për përfaqësuesen e Malit të Zi, Vukçeviçi ka luajtur 45 ndeshje dhe ka shënuar dy gola.

### Maignan në 'radar' të Bayernit dhe Unitedit

Mike Maignan, pas paraqitjeve të mira me Milanin, ka shkaktuar interesimin e dy gjigantëve evropianë si Bayern Munchen dhe Manchester United. Kontrata e francezit me kuqezinjtë përfundon më 30 qershor 2026 dhe drejtuesit e italianëve janë shprehur të gatshëm për t'ia rritur rrogën gardianit. Bayerni është në kërkim të një portieri cilësor për të ardhmen dhe Maignan është përfolur si një nga emrat më interesant. Unitedi nuk është i bindur nga Onana. Gjithsesi Milani do të përpiqet ta bindë "gardianin" që të vijojë ta mbajë fanellën kuqezi.

### Torresi e mendon largimin nga Barcelona

Ferran Torres ka humbur rëndësinë në ndeshjet e fundit të Barcelonës për shkak të formës së mirë të Joao Felix dhe rikuperimit të Rafinhas. Ndaj, sipas "Mundo Deportivo", sulmuesi është i hapur për një ndryshim të mundshëm të skuadrës. Ardhja e Vitor Rokes në merkaton e dimrit do ta shtojë konkurrencën për sulmuesin e Barçës dhe valenciani nuk do ta përjashtonte largimin nga klubi nëse paraqitet një mundësi tërheqëse. Kujtojmë se Torresi ka kontratë me Barcelonën deri në vitin 2027, me një klauzolë prej një miliard eurosh dhe synon të jetë pjesë e kombëtares spanjolle në "Euro 2024". Për këtë ai shpreson të luajë në një skuadër që i garanton vendin e titullarit.

## E dëshirojnë Reali dhe Bayerni, Alonso: Ndihem mirë në Leverkusen

Trajneri i Bayer Leverkusenit, Xabi Alonso, është kthyer në një nga trajnerët më të lakuar në Evropë, derisa mediet raportojnë për një interesim të fortë nga ana e Real Madridit, si pasues i Carlo Ancelottit. Në të njëjtën kohë shihet edhe në stolin e Bayernit. Tekniku spanjoll nuk ka pëlqyer t'u përgjigjet pyetjeve në lidhje me të ardhmen e tij, aq më pak pyetjes nëse në kontratën e tij ka një klauzolë që e lejon të largohet për te Reali. "Klauzola? Këto janë çështje kontraktuake. Unë ndihem shumë mirë këtu. Jam shumë i lidhur me këtë klub", u shpreh Alonso për "Movistar+".

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,Neni 16, pika4, Kompania NPT "Ajka" Prizrennë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përQumështoren Ramadan Memaj B.I.,Lutogllavë, Prizren

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 29.01.2024 në ora 10:00 në HFMU "Besim Nrecaj" fshati Legjende ish Lutogllave Prizren,do të organizohet Debat Publik nga KompaniaNPT "Ajka" Prizren,në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM.

https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1

Meeting ID: 454 934 4495 Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë NPT "Ajka" Prizren, për Qumështoren Ramadan Memaj B.I., Lutogllavë, Prizren.

https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimin e Bordit të datës 02.10.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës me kohë të pacaktuar, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 08.12.2023 të Rishpall:

## KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

**Zyrtar/e Administrativ/e** - Mitrovicë me kohë të pacaktuar
**Numri i referencës: 10-02-60**

**Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:**

- Kryen të gjitha punët e Zyrtarit të cilat i përcaktonë Kryeshefi Ekzekutiv ;
- Pranon palët dhe i prezenton te K.E për pranim;
- Mban evidencën zyrtare të thirrjeve telefonike dhe takimeve;
- Pranon thirrjet dhe shkresat, kryen punët kompjuterike nga fushëveprimtaria e punëve dhe detyrave të punës, si dhe punë tjera teknike që i cakton Kryeshefi Ekzekutiv , siq janë:
- Shumëzimi dhe fotokopjimi i materialeve, mbajtja e protokolit dhe arkivimi i dokumenteve dhe të postës për dorëzim intern dhe ekstern, i të njejtave;
- Kryen edhe detyra tjera të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga K.E;
- Si dhe punë tjera të kësaj natyre.

**Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:**

- Të ketë shkollën e mesme ;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Shkathtësi në komunikim;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Exel); ose administrative.
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës)

**Kushtet e veçanta:**
Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.
Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetat ditore prej 08.12.2023 deri më datën 23.12.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.




RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Sabahate Byci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

Naim Memaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Sitki Shefqeti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "28 Nëntori " Brodosan Dragash.

Qendrim Kabashaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.

Sadri Thaqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Zef Lush Marku" Velezhe.

Milica Mitic shpall te pavlefshme dëftesat e kl I,II,III,IV dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

Arbenit Sadiku shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Dr. Valon Hyseni me numër të licencës: KO-05171-01-22, shpall të pavlefshme vulën.

Dr. Ditor Haliti me numër të licencës: KO-03372-01-22, shpall të pavlefshme vulën.

Dr. Arsim Gërxhaliu me numër të licencës: KO-01376-01-22, shpall të pavlefshme vulën.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.


100% Fresh & Natural
VIDAS
Llatte drink
2%
VIDAS
TAMËL
PRODHUAR ME FINESË DHE DASHURI
2,8%
VIDAS
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
VIDAS
JOGURT
VIDAS
DHALLË


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues